



VENDIM

Nr. 7, Datë 20.09.2007

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 7638, datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";

Sot me date 20.09.2007, unë Bashkim Ulaj, me cilësinë e Ortakut të vetëm të Shoqërisë "LESKOVA", person juridik shqiptar, i regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare, me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 1365, date 03.02.1994, sipas rendit te ditës;

VENDOSA:

1. Miratimin e Aktit të Ekspertizës të kryer nga Zj. Tatjana Filto (Kotepano), Eksperte Kontabël e Autorizuar, me Nr. Licence 067, ngarkuar me Vendimin Nr. 6, date 10.09.2007 te Ortakut te Vetem te Shoqerise "LESKOVA" Shpk, për kryerjen e aktit të ekspertizës për rritjen e kapitalit të Shoqërisë.
2. Rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë "LESKOVA" Shpk, ne shumën **3 160 172** lekë (tre milion e njeqind e gjashtedhete mije e njeqind e shtatedhete e dy leke), si rikapitalizim i fitimit të akumuluar në vite nga ana e Shoqërisë dhe rezerva ligjore. Qe nga ky moment kapitali i ri i shoqerise i regjistruar eshte: 3 160 172 leke plus kapitalin ekzistues 3 966 000 leke, i cili perfshin edhe kapitalin fillestar 100.000 Lekë (njëqind mijë), **i barabarte me 7 126 172 Leke** (shtate milion e njeqind e njezet e gjashte mije e njeqind e shtatedhete e dy leke).
3. Depozitimimin e Vendimit Nr. 7, datë 20.09.2007, të Ortakut të Vetëm pranë Qendres Kombetare te Regjistrimit, për t`u pasqyruar ndryshimet përkatëse.

**ORTAKU I VETËM I SHOQERISE
"LESKOVA" SH.P.K**

BASHKIM ULAJ

